



PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE

Nr. 72

Datë: 28. 10. 2021. Ora: 10:00

Vendi: Selia e KQZ-së/ Prishtinë.

Kreshnik Radoniqi, kryetar i KQZ-së.

Anëtarët e KQZ: Sami Kurteshi, Alim Rama, Arianit Elshani, Ilir Gashi, Florian Dushi, Ibrahim Selmanaj, Rifat Krasniq, Čemailj Kurtiši, Fazli Stollaj.

SKQZ: Burim Ahmetaj, kryeshef.

ZRPPC: Yll Buleshkaj, drejtor.

Përkthyes: Argjina Misini; Jehona Cami

Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi.

RENDI I DITËS

1. Hyrje: z. Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së:
2. Shpallja e Rezultateve Përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për Kryetarë të Komunave të mbajtura më 17 tetor 2021.
3. Të ndryshme.

1. Hyrje z. Kreshnik Radoniqi Kryesues i mbledhjes së KQZ-së

Kreshnik Radoniqi: E hapim mbledhjen e 72-të të KQZ-së sipas rendit të ditës ! Sot, e kemi shpalljen e rezultateve përfundimtare por paraprakisht, meqenëse me vendim të KQZ-së është shkuar në rinumërim të tetë (8) vendvotime për kryetar komune, raporti lidhur me rinumërimin iu është dorëzuar pak më herët!

la japë fjalën krye shefit që t'a bëjë një shpjegim por, e propozoj edhe këtë pikë të rendit të ditës. Nëse ka dikush diçka tjetër lidhur me rendin e ditës, atëherë kush është për këtë rend të ditës ?

Miratohet rendi i ditës.

Burim Ahmetaj: Faleminderit kryetar, të nderuar anëtarë të KQZ-së: me vendim të KQZ-së, janë rinumëruar 8 vendvotime të cilat, kanë pasur ngatërrim rubrikash dhe për QNR-në ka qenë e pamundur me të dhënat që kanë qenë në formular të rezultateve të klasifikohen se për cilën kategori bëhet fjalë. QNR, i ka rinumëruar 8 vendvotime dhe pas rinumërimit, rezultatet e tyre janë përfshirë në rezultatet përfundimtare dhe konfirmoj se rezultatet sa i përket subjekteve politike, përveç gabimeve të vogla teknike apo gabimeve njerëzore, nuk ka pasur dallim të votave të subjekteve ndërsa problemi kryesor ka qenë ngatërrimi i rubrikave dhe i kategorive sidomos fletëvotimeve të përdorura, të pa përdorura, nënshkrimet në listën përfundimtare të votuesve dhe fletëvotimet brenda kutisë së votimit. Pas rinumërimit, janë krijuar formularët e rezultateve të reja të cilat janë proceduar në bazën e të dhënave dhe konfirmohet se këto rezultate, janë përfshirë në rezultatet përfundimtare dhe nuk kanë mospërputhje. Në tabelë, e shihni diferencën para dhe pas rinumërimit, do të thotë si kanë qenë rezultatet e vendvotimeve në vendvotim dhe cilat janë rezultatet pas rinumërimit në QNR dhe, nuk ka tejkallim të nivelit të tolerancës pas procesit të rinumërimit.

Kreshnik Radoniqi: Faleminderit. A ka dikush diçka lidhur me këtë ?

2. Shpallja e Rezultateve Përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për Kryetarë të Komunave të mbajtura më 17 tetor 2021:

Kreshnik Radoniqi:

“Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës! Të nderuar përfaqësues të mediave ! Fillimisht, dua të ju njoftoj se në vazhdim do të shpallim rezultatet përfundimtare të Raundit të Parë të zgjedhjeve për Kryetar të 38 komunave të cilat, u mbajtën më 17 tetor 2021. Në QNR kanë përfunduar të gjitha procedurat e parapara në mënyrë që KQZ të shpall këto rezultate. Vendimi i ditës së sotme, më 28 tetor 2021 përfshin rezultatet përfundimtare të raundit të parë të zgjedhjeve për kryetarë të 38 komunave.”

Në vazhdim, do t'i shpallim rezultatet veç e veç, për çdo komunë.

Alim Rama: Është një ankese që ka të beje më kandidatet për kryetare komune e cila pas vendimit të PZAP-ë mund të jete objekt i shqyrtimit edhe nga gjykata supreme. Ne, nuk mundemi me paragjykuar që s'mundet më pasur ankesa kështu që unë mendoj që pasi ankesa është në ditën e zgjedhjeve në proces nuk është ne rezultate mendoj që ne nuk duhet të shpallim as rezultatet.

Arianit Elshani: E para, për shpalljen e këtyre rezultateve ka disa dite që është bërë një presion jashtëzakonisht i madh brenda sekretariatit, brenda QNR-së lidhur më shpalljen e rezultateve. Ndoshta ndonjëherë edhe duke tejkeluar të gjitha ato procedura, standarde që janë të vendosura për rinumërimin e kutive dhe nëpër cilat, do të kaloj çdo vendvotim. Nuk e di për çfarë arsye është bërë kjo ?

Ne, jemi brenda afateve kohore, brenda afatit operacional lidhur më rundin e dytë dhe sigurisht lidhur më ketë komunë, me komunën e Hanit të Elezit, po ashtu kemi kërkuar edhe nga KQZ-ë pra që të shkojnë pako të gjitha këto dhe të pritët deri në një vendim përfundimtar: pra, edhe nga PZAP-ja, edhe nga gjykata supreme. Nuk e di pse gjithë ky insistim, pse edhe kjo mbledhje sot të mbahet herët! Ndoshta, kemi mundur të presim për një ore më të vonë lidhur më ketë mbledhje dhe shpalljen e këtyre rezultateve dhe prandaj, vërtet kam shumë arsye që të duket tendencioze kjo çështje pra që sot, tan,i edhe nga kjo mbledhje të ndahet kjo komunë nga publikimi i rezultateve kur ndoshta, në ora 3 apo 4, ne kemi mundur që të gjitha këto t'i shpallim pa bërë ndarje të komunave veç e veç. Si do qoftë, është në përgjegjësinë tuaj kryesues, por unë insistoj që kjo të jete brenda meqenë se është përfshire brenda publikimit, përkudër çfarëdo lloj vendimi që do të merr gjykata supreme. Ne, kemi parë vendimin e PZAP-it dje, sigurisht nëse ka ndonjë vendim të kundër, aty mund ta largojmë ketë rezultat por mendoj që edhe vendimi paraprak i gjykatës supreme dhe vendimi i djeshëm i PZAP-së, tashmë ka betonuar në njëfarë forme edhe këtë çështje dhe gjitha ato akuza dhe dyshime që kanë qenë, janë vërtetuar si të pa baza. Por nuk është çështje e interpretimit tonë prandaj, mendoj se duhet të jetë brenda shpalljes komuna e Hanit të Elezit, nuk mendoj që e pengon vendimin...

Kreshnik Radoniqi: Faleminderit z. Elshani, dikush tjetër?

Unë para vetit i kam dy shkresa: një nga PZAP-ja dhe një nga kryetari i Gjykatës Supreme. PZAP, dje, para së më u marr vendimi për rastin e Hanit të Elezit na e ka dërguar një shkresë ku ka treguar që për Hanin e Elezit nuk mund të shpallet rezultati se ende nuk është vendosur, por dje gjatë ditës është vendosur për ankesën lidhur me Hanin e Elezit. Ndërsa, nga kryetari i gjykatës supreme e kemi një shkresë tjetër i cili thotë se rezultati për Hanin e Elezit nuk mund të certifikohet, pra, ne sot vetëm jemi duke bërë shpalljen dhe nuk jemi duke i certifikuar rezultatet. Ne, nuk dimë a do të parashtrohet ankesë apo jo! Supozojmë

që do të parashtrohet por, ne nuk jemi duke certifikuar rezultatet prandaj, unë mendoj se mund ta bëjmë shpalljen. Cka ndodh tutje, e drejta e ankesës mund të bëhet brenda 24 orëve pas të shpalljes, pra nëse mendoni që s'doni me i shpallë, unë ua lë juve të vendosni. Urdhëroni...?

Sami Kurteshi: U përmenden disa çështje se ka pasur presion...! Ne, duhet me e refuzuar çfarëdo presioni, se KQZ-ë ka për detyrë më shqyrtuar çfarëdo shkelje që behet nga KQZ-ja apo na dikush tjetër në raport më votat kjo është problemi, çështja është se kur thuhet kështu dikush e ndijën veten fajtor. Unë, e ndjej veten fajtor, dhe çështja e parë është kjo! Megjithatë, unë mendoj se nuk bën me e gjuajt gurin dhe me e fsheh dorën sepse, krejt e ndijën veten fajtor: kush po bejka presion. Çfarë presioni? Naj kujt po u bëka...? Ky është problemi, e dyta tani fillon afati i ankesave për çka për shpallje të rezultateve apo për certifikime, këtu i kemi dy raste pastaj: një për shpalljen e rezultateve për gjitha komunat për cilat u krye procedurat. Nuk kemi proces të hapur për një komunë që ende vërtet nuk i ka krye procedurat: është në proces gjyqësor...Unë, nuk e di deri kur e kanë ata afatin me shtruar ankesa por, unë mund të pajtohem pjesërisht me fjalën e kolegut! Ndoshta, ne kemi mundur me prit një 2 apo 3 orë, me pa a po shtrojnë ankesë apo, nuk shtrojnë ankesë në gjykatën supreme. Nëse nuk shtrojnë ankesë, kishte me përfunduar dhe vërtetë ne kishim pasur arsye të plote me krye këtë punë. Por, është procesi i hapur dhe nuk e di a është në rregull apo nuk është në rregull. Unë mendoj se pasi që i kemi shkresat dhe ende na thonë që është në procedurë, nuk jam bash i bindur që do duhej mu fut në rezultate...

Ilir Gashi: Shkresën që ju referua z. Rama, është shkresë para vendimit të PZAP-it d.m.th, ajo shkresë është gjatë ditës ku pastaj pasdite PZAP-ë ka marr vendim që ka hedhur poshtë ankesën e kandidatit të pavarur z. Suma. Kështu që, kemi një realitet të ri. Ne, nuk flasim hipotetikisht nëse ai do të vazhdoje tutje në gjykatën supreme për të ankimuar vendimin e PZAP-it, pastaj e kemi edhe një përgjigje nga gjykata supreme ku flet për certifikime dhe jo shpallje dhe parimisht, të gjitha shpalljet e rezultateve sot mund të ankimohen brenda 24 orëve pavarësisht se cilës komunë i përkasin kështu që, z. Elshani foli për kohën se për faktin se deri në ora 13:00, edhe ashtu, është koha kur do të apelohej vendimi i PZAP-së dhe kemi mundur me pritë por, sido që të jetë jam dakord që ne të procedojmë me shpallje të rezultateve sepse, nuk po i certifikojmë...

Alim Rama: Unë, ju ktheva procedurave, procedura thotë që ankesa është për ditën e zgjedhjeve është në procesin zgjedhor...Kjo ankesë, është në proces e sipër dhe ka mundur më ardhur vendimi pas shkresën që kemi pranuar ne dje, por edhe ai vendimi është i apeluar d.m.th, krijohet 24 orë - plus 72 orë për vendimin e gjykatës supreme...

Arianit Elshani: E para, nuk pata personale me asnjë anëtar por nuk mendoj që dhe nuk pres që anëtarët të bëjnë presione në KQZ-ë dhe sekretariat, pra, nuk mendoj që nga anëtarët ka pasur presione lidhur me shpalljen e rezultateve mirëpo, ka qenë vetvetiu brenda sekretariati një nguti për të shpallur rezultatet sa më shpejt dhe unë jam kundër për të shpallur rezultatet shpejt e shpejt pa kaluar nëpër të gjitha filtrat, pa kaluar nëpër të gjitha procedurat. Ne po flasim për një vullnet qytetar të shprehur përmes votës, pra po flasim për komunat që kanë përfunduar me rundin e parë dhe, për ato që kanë nevojë që të shkojnë edhe në rundin e dytë... Pak më parë, ne votuam një komunë që këtu është thënë që nuk kemi raport të qartë të policisë lidhur me një kuti të votimit në Fushë Kosovë, e votuam edhe pse z. Rama ne bashkërisht këtu, unë, ti dhe z. Kurteshi nuk e kemi votuar në parim në mbledhje Fushë Kosovën! Atë kuti të votimit, dhe tani kemi një komunë, Hanin e Elezit për të cilën thuhet qarte se certifikimi nuk mund të bëhet pa u shfrytëzuar të gjitha mundësit e palës që e konteston procesin e ditës së zgjedhjeve por, edhe rezultatin prandaj, unë mendoj se duke e ditur që kemi planin operacional, duke e ditur që duhet të publikohen edhe fletëvotimet dhe gjitha këto, unë mendoj që është shumë në rregull me votim të Hanit të Elezit dhe ndërkohë, në qofte se ka ndonjë vendim - atë publikim edhe mund të tërheqim por, mendoj që duhet t'i japim rrugë dhe mos ta kontestojmë, mos ta minojmë këtë proces, këtë ditë të zgjedhjeve që gjithsecili e vlerëson se ka shkuar në mënyrën me të mirë...

Alim Rama: Ndërlidhja e komunës së Fushë Kosovës me këtë nuk ka të bejë, komuna e Fushë Kosovës kurrë s'ka qenë në proces gjyqësor d.m.th, nuk ka pasur ankesa në proces dhe ato janë trajtuar (nëse janë trajtuar) me një procedure dhe ajo procedura u krye dhe nuk ka pasur ankesë në PZAP, por procesin e ka marr për baze PZAP-i gjate ditës së zgjedhjeve.

Kreshnik Radoniqi: Dikush tjetër...? Nëse jo, unë megjithatë do e lexoj edhe komunën e Hanit të Elezit pastaj, do të kemi të drejt vote, do të ndërlidhem vetëm sa i përket shpalljes së rezultatit dhe jo certifikimit. Shpallja, mundet me ndryshuar, ndërkohë nëse ka ankesa lidhur më shpalljen: "Komuna e Hanit të Elezit, Mehmet Ballazhi nga PDK 2561 vota 51.33%, Rufki Suma Kandidate i pavarur 2106 vota 42.21%, Sherif Berisha LVV 322 vota 6.45%, sipas shpalljes d.m.th, Mehmet Ballazhi kalon në rundin e parë. Kush është për miratimin e Hanit të Elezit ?

Me nëntë vota për (9), miratohet rezultati për komunën e Hanit të Elezit. Dy anëtarë, nuk marrin pjesë në votim.

Rezultatet për komunat e tjera, u shpallën dhe u miratuan vec e vec për cdo komunë. Në fund, u kërkua që të njoftohen të gjitha subjektet politike dhe kandidatët se, në afat prej 24orë mund t'i paraqesin ankesat e tyre në Panelin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa lidhur më rezultatet e shpallura.

Sami Kurteshi: Dy gjera: një, duhet të caktohet ora prej kur fillon momenti i caktuar afati i ankesave dhe, e dyta, ne vendimin për shpalljen e rezultateve unë e lexova më kujdes te pika 2 mungon Vushtrria.

Kreshnik Radoniqi: Do të rishikojmë vendimin prapë, urdhëro Z. Dushi ?

Florian Dushi : Më një kontekst krejt tjetër ! Këtu, u përmend edhe rezultati sa i përket asambleve komunale dhe kandidateve të tyre. Konsideroje se është më rendësi që afërsisht të i njoftoj që rezultatet do të shpallen të gjitha. Një kohë, pritjet edhe të miat kanë qene të tilla prandaj, është me rendësi t'i njoftojmë kur afërsisht mendojnë që ato rezultate të jenë të gatshme për t'u shpallur nga KQZ-ë sepse, është shumë e thjeshtë: procedurat duhet të fillojnë me komunat të cilat kemi fitues në rundin e parë, ndërkohë, mendoj që paralelisht do të duhej të shkoj edhe përbërja e kuvendeve komunale me marrjen e detyrës nga kryetari i komunës.

Burim Ahmetaj: Faleminderit kryetare votat më kusht janë numëruar për kryetare komune dhe asamble komunale edhe të cilat janë publikuar po ashtu edhe votat personave më nevoja të veçanta dhe njejte ka ndodhur edhe më votat jashtë vendit të cilat janë numëruar dhe janë përfshire të gjitha këto rezultate në rezultatet përfundimtare sa i përket rezultateve për kuvend komunal janë edhe dy raporte të cilat jemi duke i përgatitur është raporti i verifikimit të vendvotimeve krahasimin e rezultateve në mes formularëve të rezultateve të kandidateve dhe fletave llogaritëse të kandidateve.

Po ashtu, është raporti i krahasimit të rezultateve të rinumërimit para dhe pas rinumërimit. Pasi t'i sjellim këto dy raporte, varësisht se çka ka gjetura në këto dy raporte, atëherë do mund të vazhdojmë më tutje kështu që besoj shumë shpejt do të përgatitin dhe mbledhjen e radhës do të KQZ-së do të jene gati për tu prezantuar dhe pastaj do të dimë sakte se kur do mund KQZ-ë të shpall rezultatet, raportin do të sjellim nesër dhe pastaj do të dimë sakte nga raporti së si është gjendja mirëpo konfirmoje që rezultatet përfundimtare atyre që janë në rregull u janë bashkuar rezultatet e votave më kusht votat e personave më nevoja te veçanta dhe votat jashtë vendit të cilat janë në rregull dhe nuk ka ndonjë problem.

Alim Rama: Ne, në një mbledhje të KQZ-së kemi kërkuar që këto rezultate të shpallen në mënyrë progresive në mënyrë parciale duke marr parasysh që kandidatet për asamble ende nuk janë të sigurt për radhitjen e tyre kështu që unë kisha kërkuar që gjitha ato që janë parciale të publikohen që më pas mundësi ata të verifikojnë së cili kandidate për asamble më pas mundësin mi trajtuar të dhënat e veta më përgatitur të gjitha ankesat në qofte së janë në proces kështu që nuk kane nevojë me prit vetëm rezultatet përfundimtarë pastaj kane vetëm 24h ata më dyshuar në proces.

Arianit Elshani: Pajtohem më këtë kërkesë dhe kërkoje nga sekretariati më qene së kam marr shumë mesazhe nga kandidatet për asamble komunale të cilët po i shikojnë FRK-të në ueb të KQZ-së dhe kërkoje nga ju krye shef që të insistoni të vendosni një person përgjegjës i cili shikon secilin formularë të rezultateve a është u publikuar në ueb të KQZ-së.

Burim Ahmetaj: I kemi publikuar të gjitha formularët e rezultateve dhe qofte për kryetare komune po ashtu, edhe për asamble komunale dhe për kandidate për secilin vendvotim, mund të ketë gabime teknikë do të kontrollojmë dhe verifikojmë së a janë publikuar të gjitha formularët e rezultateve të krijuara në vendvotim e kemi obligim më i publikuar të gjitha këto rezultate dhe pas verifikimit do të marrim masa të publikojmë edhe ato që mungojnë.

Në anën tjetër, kemi publikuar të gjitha rezultatet e vendvotimeve të rinumëruara si dhe rezultatet e votave më kusht më poste dhe votave të personave më nevojë te veçanta që janë një kategori të votave më kusht, të gjitha këto rezultate janë të publikuara në mënyrë progresive sidomos pjesa që janë numëruar në QNR-ë dhe mund të gjeni në ueb faqen e KQZ-së. Do të përgatitem raportin e vendvotimeve të cilat janë rinumëruar dhe krahasimet e rezultateve para dhe pas rinumërimit, mirëpo në anën tjetër do të i bëjmë edhe kontroll data bazës për të pare në raste se një subjekte ka akoma vota dhe kandidatet nuk kane vota do të na duhet më gjete edhe më gjete një arsye sepse supozojmë së subjekti ka 10 vota kandidati 0 vota edhe këtë kontroll të data bazës do të bëjmë në mënyrë që të jemi të sigurt që anëtarët e këshillave të vendvotimit i kane përshkruar sakte rezultatet.

Kreshnik Radoniqi: Faleminderit, atëherë para se me e përfunduar mbledhjen edhe njëherë për ankesat që kanë kandidatet apo subjektet politike: afati 24 orë, përfundon nesër në ora: 11:10 minuta...

Mirupafshim në takimin e radhës!